



Datë: 27.10.2025

Numër Protokolli: 7015/2025

A.nr.1769/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-Kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtare, me Flakron Gashi-në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1769/2025 të datës 08.10.2025 të parashtruar nga ankuesi Xh.S, nga Istogu, kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.10.2025 mori:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *shpallet jo kompetent* për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës A.nr.1769/2025, të datës 08.10.2025, të parashtruar nga ankuesi Xh.S.

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Xh.S (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), më datë 03.10.2025 përmes poste ka parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datë 08.10.2025 nën shenjë A.nr.1769/2025, kundër Shërbimit Korrektues të Kosovës për shkak të mosveprimit sipas Vendimit të datës 22.05.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore, për kompensimin material të pretenduar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.10.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të SHKK, ndërsa kjo e fundit më datë 13.10.2025 ka dërguar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke vepruar sipas ankesës së ankuesit administroi këto prova: Ankesën me nr. protokolli 6634/2025 të datës 08.10.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 22.05.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të SHKK-së, Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 10.10.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 13.10.2025; Kontratën e punës së ankuesit të datës 19.06.2018; Rekomandimin e datës 16.05.2018; Kërkesën e ankuesit të datës 13.05.2025; Vërtetimin e datës 13.10.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të SHKK-së; Listën e pagave të ankuesit.

Kolegji i Këshillit (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, Xh.S *sepe*:

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës në këtë procedurë administrative, gjegjësisht Kontratës së Punës të datës 19.06.2018, të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, konstatoi se ankuesi është i punësuar në Qendrën Korrektues në Dubravë/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në pozitën e punës “**Zyrtar Korrektues**” dhe po ashtu është konstatuar edhe përmes Vërtetimit të datës 13.10.2025 të lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të SHKK-së, dëshmohet fakti se ankuesi mban pozitën e njëjtë të punës.

Tutje, ankuesi me datë 08.04.2025 i është drejtuar Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të SHKK-së, me kërkesën për njohjen e kompensimit material, respektivisht të drejtën për realizimin e pagës jubilarë duke iu referuar dispozitave të Ligjit nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me datë 22.05.2025 ka nxjerrë Vendimin Nr.208 përmes të cilit ankuesit i është njohur e drejta në kompensim material në vlerën prej 363.00 € euro në emër të shërbimit jubilar, mirëpo ankuesi për shkak të mos ekzekutimit të Vendimit të datës 22.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshill me pretendimin ankimor se organi i punësimit nuk po ia ekzekuton të drejtën e aprovuar lidhur me kompensimin material të pretenduar.

Kolegji i Këshillit para se të lëshohet në shqyrtimin meritore të rastit lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit në këtë çështje administrative, analizoi bazën ligjore në fuqi me qëllim të konstatimit të kompetencës lëndore, respektivisht Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 ku është përcaktuar se: “*1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës*” si dhe po ashtu janë marrë për bazë edhe dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-294 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.08/L-197 Për Zyrtarët Publik, ku në nenin 6 përcaktohet si në vijim: “*Neni 6 i ligjit bazik ndryshohet si në vijim: Neni 6 Nëpunësi civil me status*

*të veçantë 1. Nëpunësi civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunësit civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarit e Shërbimit Korrektues të Kosovës, **përgjashtimisht zyrtarët korrektues**”, andaj duke u mbështetur në nenin 19 të të njëjtit ligj, i cili është publikuar në gazetën zyrtare me datë 02.06.2025, i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 17.06.2025, nga rrjedh se zyrtarët korrektues në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, më nuk e ka statusin e nëpunësit civil.*

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit duke iu referua aktit të themelimit të marrëdhënies së punës së ankuesit, gjegjësisht kontratës së punës në të cilën përcaktohej se marrëdhënia e punës ndër tjerash është lidhur edhe mbi bazën e Ligjit të Punës, prandaj në mbështetje të nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, Kolegji i Këshillit thekson faktin se Zyrtarët Korrektues në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-294 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtaret Publik, fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Prandaj, në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, andaj, pas konstatimit se ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit bazuar në nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke marr parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka kompetencë për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1769/2025, atëherë bazuar në nenin 75 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1769/2025, datë 27/10/2025

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Xh.S;
- Shërbimit Korrektues të Kosovës (Komisionit të Ankesave dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.